

Që të tretë u vranë më **11.08.1998**, gjatë luftimeve me forcat serbe në qendër të **Gllgjanit/Glodane**. Janë varrosur së bashku në varrezat e fshatit. Pas përfundimit të luftës, mbetjet e tyre mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Gllgjan/Glodane.

Burimet: deklarata V.S, FDH-29919; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Antun Željko (Petar) Martinović

(24.05.1967, serb nga Prizreni/Prizren, dy fëmijë, pjesëtar i UJ-së)

Antun Željko u lind në Vukovar. Jetonte me familjen në *Rrugën e Gjerdapit/Đerdapska* në Prizren. E kishte mbaruar Akademinë Ushtarake të Forcave Tokësore. Me gradë kapiten, ishte komandant i njësitit tankist në kuadrin e Brigadës së Motorizuar 549. Antun Željko u vra më **11.08.1998**, nga ora 16:00, në **Gllgjan/Glodane**, kur tanku i tij u qëllua me një predhë.

Burimet: USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 40.

Enver (Hasan) Halilaj

(24.11.1962, shqiptar nga Gllgjan/Glodane, komuna e Deçanit/Deçani, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Orhan (Lan) Halilaj

(13.03.1979, shqiptar nga Gllgjan/Glodane, komuna e Deçanit/Deçani, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Enveri e kishte mbaruar Shkollën e Lartë të Policisë në Vushtrri/Vučitrn. E pushuan nga puna në vitin 1990. Më pas punonte si taksist në Deçan/Deçane. Aderoi në UÇK në muajin prill të vitit 1998. Ishte i angazhuar në trajnimin e ushtarëve të rinj. Në të njëjtin njësit, së bashku me të, ishte edhe i afërmi i tij, Orhani. Ai u inkuadrua në UÇK në fund të muajit prill të vitit 1998. Disa herë ka shkuar për në Shqipëri për të sjellë armatime të reja në Kosovë. Që të dy kanë pësuar nga ciflat e predhës minahedhëse, e cila ka rënë në afërsi të shkollës fillore *Hasan Prishtina* gjatë sulmit të forcave serbe

ndaj **Gllgjanit/Glodane**, më **11.08.1998**. Sot, ata prehen në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Gllgjan/Glodane.

Burimet: deklarata S.H, FDH-31225; deklarata Z.N, FDH-12427; deklarata H.H, FDH-12776; deklarata Z.S, FDH-12766; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Maxhun (Malë) Çeku

(10.05.1941, shqiptar nga Irzniqi/Rznic, komuna e Deçanit/Deçani, mësues, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Naser (Muzli) Idrizaj

(26.10.1966, shqiptar nga Kodralia/Kodralija, komuna e Deçanit/Deçani, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Gëzim (Shaban) Dervishaj

(18.11.1978, shqiptar nga Irzniqi/Rznic, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Maxhuni e ka mbaruar Shkollën për Oficerë Rezervë gjatë kryerjes së shërbimit të rregullt ushtarak. Më pas e ka kryer Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe, për një kohë, punoi si mësues në shkollë në Irzniq/Rznic. Pas përfundimit të Fakultetit të Mbrojtjes në Beograd, ka dhënë mësim në gjimnazin e Deçanit/Deçane. Menjëherë pas shpërthimit të luftës, Maxhuni iu bashkëngjiti UÇK-së. Në fillim të prillit të vitit 1998, ai u emërua komandant shtabi në Irzniq/Rznic.

Naseri u bë anëtar i UÇK-së më 20.04.1998 dhe së shpejti u emërua komandant i njësitit në fshatin e tij të lindjes Kodrali/Kodralija.

Gëzimi e ka braktisur klasën e katërt të shkollës së mesme dhe hyri në radhët e UÇK-në në Irzniq/Rznic. Pas mbarimit të trajnimit ushtarak, ishte i angazhuar për trajnimin e ushtarëve të rinj.

Në datën **11.08.1998**, Maxhuni, Naseri dhe Gëzimi ishin të pozicionuar në lokacionin e quajtur *Gërdajë/Gerdaja*, në **Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg**, kur forcat serbe e sulmuan fshatin. Naseri dhe Maxhuni u vranë menjëherë, ndërkaq Gëzimi u plagos rëndë. Pjesëtarët e UÇK-së e kanë çuar menjëherë Gëzimin në spitalin e UÇK-së në Irzniq/Rznic, por ai